



## UDHËZIM

Nr. 5166, datë 20.10.2016

**PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE  
DHE PROCEDURAVE TË TJERA SHITESË  
NË SQARIM TË KRITEREVE TË  
PARASHIKUARA NË NENIN 133, SI DHE  
PËRCAKTIMIN E KUSHTEVE DHE  
PROCEDURËS SË MARRJES SË  
LICENCËS OSE RIPËRTËRITJEN E SAJ,  
NË BAZË TË NENIT 134, TË LIGJIT NR.  
35/2016, DATË 31.3.2016, “PËR TË  
DREJTAT E AUTORIT DHE TË DREJTAT  
E TJERA TË LIDHURA ME TO”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, e Kushtetutës dhe nenit 158, të ligjit nr. 35/2016, datë 31.3.2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”,

## UDHËZOJ:

## KREU I

## DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

## A. Qëllimi i udhëzimit

1. Nëpërmjet këtij udhëzimi përcaktohen kriteret profesionale, të cilat duhet të përmbushen nga Agjencitë e Administrimit Kolektiv (këtej e tutje “AAK-të”) dhe procedurën e mbajtur nga Drejtoria e të Drejtës së Autorit (këtej e tutje “DDA”), për marrjen e licencës apo ripërtëritjes së saj nga ministria përgjegjëse për të drejtën e autorit, në ushtrimin e administrimit kolektiv të të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to.

2. Kriteret dhe procedura shtesë e këtij udhëzimi janë në sqarim dhe në bazë të neneve 133 dhe 134, të ligjit nr. 35/2016, datë 31.3.2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”.

## B. Kriteret profesionale

Për të kryer administrimin kolektiv të të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to, AAK-ja, duhet të ketë:

1. Selinë e saj të ushtrimit të veprimtarisë në Republikën e Shqipërisë;

2. Kushte të përshtatshme me pajisje të teknologjisë së informacionit për të kryer normalisht funksionet e saj;

3. Ekspertizë dhe shërbim teknik dhe logjistik të përshtatshëm për njohjen e të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to, në nivel

kombëtar dhe ndërkombëtar, gëzimin e mekanizmave të mjaftueshëm për mbledhjen dhe shpërndarjen e shpërblimeve kundrejt anëtarëve titullarë të të drejtave, ekspertizën profesionale me të paktën një punonjës jurist dhe me njohuri të gjuhëve të huaja;

4. Një ekspertizë profesionale me një punonjës me njohuri në fushën financiare dhe të kontabilitetit;

5. Punonjësit e Agjencive të Administrimit Kolektiv me njohuritë e parashikuara në pikat 3 dhe 4, më sipër, të këtij kreu; punonjësit që kryejnë detyrat e inspektimit në bazë dhe për zbatim të ligjit 35/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to” dhe ligjit “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” janë të detyruar të kenë kryer studimet në nivel Bachelor ose Master për pronësinë intelektuale brenda 3 viteve nga hyrja në fuqi e ligjit nr. 35/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”. Mospërbushja e kësaj pike, pas kalimit të afatit 3-veçar nga hyrja në fuqi e ligjit, përbën kusht për pezullimin e licencës deri në përmbushjen e këtij kriteri profesional;

6. Kualifikimet profesionale dhe njohja e gjuhëve të huaja, të përmendura në pikat më sipër, duhet të vërtetohen me dëshmitë përkatëse.

C. Kontraktimi për kryerje të funksioneve dhe shërbimeve specifike

1. AAK-ja mund të pajtojë për kryerjen e ndonjë funksioni ose asistencë administrative, teknike specifike ose që ndihmon funksionimin normal të saj, një person tjetër fizik ose juridik. Në çdo rast, subjektet në fjalë duhet të përmbushin kriteret e parashikuara në ligj për kryerjen e punëve të tilla dhe në çdo rast punonjësi duhet të plotësojë kriteret e përcaktuara në këtë udhëzim.

2. AAK-ja, në përputhje me nenin 136, pikat 2 dhe 3, të ligjit “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to” do të konsiderohet se i plotëson kriteret në lidhje me shërbimet e saj teknike dhe logjistike edhe nëse funksionet ose asistencat administrative, teknike specifike, brenda fushës së aktiviteteve të saj, që kanë të bëjnë me administrimin e të drejtave përkatëse, do të kryhen nga shërbimet teknike dhe logjistike të një AAK-je tjetër, e cila është pajisur nga ministria përgjegjëse për të drejtën e autorit, për administrimin e një kategorie të caktuar të të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to. Të gjitha të drejtat



dhe detyrimet mes dy Agjencive të Administrimit Kolektiv do të rregullohen nëpërmjet një kontrate/marrëveshje të miratuar nga organet vendimmarrëse të tyre në mënyrë respektive, duke marrë parasysh shkurtimin e kostove dhe administrimin me efikasitet dhe rentabilitet të këtyre agjencive. Në çdo rast, në bazë të këtij ligji, çdo agjenci ka detyrimin të kryejë me mjetet dhe shërbimet teknike e logjistike të veta shpërndarjen e të ardhurave të mbajtësit e të drejtave të autorit dhe të drejtave të lidhura me to, për çdo vit kalendarik përkatës.

## KREU II KËRKESA PËR LICENCIM OSE RIPËRTËRITJEN E SAJ

### A. Përmbajtja e kërkesës

1. Kërkesa për licencim ose ripërtëritje të licencës për Agjencinë e Administrimit Kolektiv, për kryerjen e veprimtarisë së përmendur në kreun I, germa “A” të këtij udhëzimi, duhet të përmbajë:

a) emrin dhe vendin ku AAK-ja do të ketë selinë e saj;

b) një ekstrakt lëshuar nga gjykata për regjistrimin e saj si OJF, organet drejtuese ekzekutive dhe kolegjiale;

c) përshkrimin e kategorisë përkatëse të të drejtave të autorit ose të të drejtave të tjera të lidhura me to, që synon të administrojë në emër të mbajtësve të të drejtave, mbajtësit e të drejtave të autorit/lidhura me to;

ç) statutin e agjencisë sipas parashikimeve të ligjit mbi OJF-të dhe rigorozisht të përfshijë në mënyrë specifike parashikimet e ligjit nr. 35/2016, datë 31.3.2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”;

d) të gjithë dokumentacionin dhe dëshmitë, parashikuar në kreun I të këtij udhëzimi, për punonjësit që do të jenë pjesë administrative e AAK-së, që vërteton kualifikimet e tyre profesionale, përvojën profesionale dhe njohuritë e gjuhëve të huaja.

2. Kërkesa e përmendur në pikën 1 të këtij kreu, duhet të shoqërohet me:

a) një listë të anëtarëve në bazë të të drejtave të autorizuar prej tyre;

b) kontrata për përfaqësim reciprok të nënshkruara me agjencitë e huaja.

3. Në rastin e përmendur në pikën 1, germa “C”, kreu I, i këtij udhëzimi, kërkesa duhet të

shoqërohet me kontratën me personin fizik ose juridik, si dhe dokumentacionin që provon se personi i plotëson kriteret e përcaktuara ligjore dhe parashikimet e këtij udhëzimi.

4. Në rastin e përmendur në pikën 2, germa “C”, kreu I, i këtij udhëzimi, kërkesa duhet të shoqërohet me kontratën/marrëveshjen me agjencinë tjetër të administrimit kolektiv, e cila është pajisur tashmë nga ministria përgjegjëse për të drejtën e autorit, për administrimin e një kategorie të caktuar të të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to.

5. Të dhënat shoqëruese të përmendura në pikën 2, germa “A”, kreu II, të këtij udhëzimi, mund të paraqiten në formë elektronike.

6. Përveç sa parashikohet në këtë udhëzim për kërkesën për licencim ose ripërtëritje të saj, AAK-ja plotëson edhe formularin e aplikimit për licencim ose ripërtëritje të saj të administrimit kolektiv për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to. Formulari miratohet nga drejtori i Drejtorisë së Drejtës së Autorit pranë ministrisë përgjegjëse për të drejtën e autorit, në zbatim të kriterëve të ligjit për të drejtën e autorit dhe këtij udhëzimi, si dhe do të shërbejë për vlerësimin e përmbushjes së kriterëve të AAK-së.

7. Pas datës së plotësimit të dosjes së paraqitur për licencë ose ripërtëritje të saj nga një AAK, në zbatim të nenin 134/2, të ligjit për të drejtën e autorit, Drejtoria e së Drejtës së Autorit njofton nëpërmjet një thirrjeje publike, në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për të drejtën e autorit edhe subjekte të tjera të mundshme, të cilat mund të kenë interes për pajisje me licencë për kategorinë përkatëse të të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to. Ky afat për depozitimin e kërkesave të reja dhe plotësimin e plotë të dosjes së aplikimit për licencim është 20 ditë kalendarike.

8. Drejtoria e së Drejtës së Autorit mban të dhënat dhe dosjen e aplikimeve të agjencive të administrimit kolektiv të të drejtave.

B. Dhënia e licencës ose ripërtëritjes së saj

1. Ministria përgjegjëse për të drejtën e autorit do të pajisë me licencë ose ripërtëritje të saj, në zbatim të neneve 133 dhe 157, pika 2, germa “ë”, të ligjit për të drejtat e autorit, vetëm ato AAK që krijohen në përputhje me ligjin për OJF-të, dhe që plotësojnë rigorozisht kriteret e ligjit “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to” dhe përmbushin kriteret e përcaktuara në këtë udhëzim.



2. Në rastet e shqyrtimit të kërkesës për ripërtëritje të licencës nga ana e AAK-së, Drejtoria e së Drejtës së Autorit pranë ministrisë përgjegjëse për të drejtën e autorit, do të vlerësojë:

a) historikun e administrimit të bërë nga agjencia në fjalë për kategorinë përkatëse për të cilën është pajisur me licencë;

b) performancën e saj në lidhje me mbledhjen dhe shpërndarjen e shpërblimeve për anëtarët e tyre;

c) performancën e saj në lidhje me shpenzimet e kryera në ushtrim të objektit të licencës;

ç) mënyrën e funksionimit të brendshëm dhe respektimit të akteve rregulluese individuale dhe kolegjiale në raport me anëtarësinë;

d) raportimin dhe përmbushjen e detyrave nga ministria përgjegjëse për të drejtën e autorit;

dh) respektimin e marrëdhënieve të reciprocitetit me agjencitë e huaja me të cilat është lidhur marrëveshje/kontratë përfaqësimi;

e) transparencën e bilanceve, informacionit dhe raportimit me organet e tjera shtetërore;

f) përmbushjen/zbatimin e parashikimeve të ligjit për të drejtën e autorit për ushtrimin e administrimit kolektiv dhe legjislacionit në fuqi.

3. Pas botimit në Fletoren Zyrtare të urdhrimit të ministrit për licencimin ose ripërtëritjen e saj të një AAK-je, agjencia është e detyruar të kryejë pagesën në përputhje me nenin 157/4, të ligjit për të drejtat e autorit dhe me VKM-në përkatëse të tarifave të shërbimeve që kryhen nga DDA-ja dhe ministria përgjegjëse për të drejtën e autorit.

4. Në rast moslicencimi ose ripërtëritje të saj, kërkuar ka të drejtën e ankimit, sipas dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë.

C. Hyrja në fuqi

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I KULTURËS  
**Mirela Kumbaro Furxhi**

## URDHËR

Nr. 6915, datë 17.10.2016

### PËR FORMËN, PËRMBAJTJEN DHE RREGULLAT E PAJISJES E ADMINISTRIMIT TË VULAVE TË PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, të neneve 15 dhe 39, të ligjit nr. 10031, datë 11.12.2008, “Për shërbimin përbarimor gjyqësor privat”, i ndryshuar, të ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe të vendimit nr. 390, datë 6.8.1993, të Këshillit të Ministrave, “Për rregullat e prodhimit, administrimit, kontrollit dhe ruajtjen e vulave zyrtare”,

#### URDHËROJ:

1. Përbaruesi gjyqësor privat paraqet kërkesë pranë Ministrisë së Drejtësisë, për pajisjen me vulën e njomë, pas certifikimit nga ministri i Drejtësisë dhe marrjes së aktit administrativ përkatës nga Qendra Kombëtare e Biznesit për ushtrimin e veprimtarisë.

2. Pajisja e përbaruesve gjyqësorë privatë me vula bëhet nga Ministria e Drejtësisë brenda 30 ditëve nga dita e paraqitjes së kërkesës.

3. Certifikimi si përbarues gjyqësor privat lëshohet vetëm për individë, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi, vula që lëshohet për ta është personale dhe përdoret vetëm nga përbaruesi gjyqësor privat, si dhe vendoset në çdo dokument që ai krijon gjatë veprimtarisë së tij profesionale.

4. Pavarësisht se shërbimi përbarimor mund të ofrohet nëpërmjet një subjekti tregtar, vula është personale dhe përdoret vetëm nga përbaruesi i pajisur me certifikatën e aftësisë profesionale të përbaruesit gjyqësor privat.

5. Veprimet përbarimore kryhen vetëm nga individë të pajisur me certifikatën e aftësisë profesionale të përbaruesit gjyqësor privat dhe nën përgjegjësinë vetjake të tyre.

6. E drejta për të përdorur vulën nuk mund t'u jepet në asnjë rrethanë të tretëve. Në rast se gjatë kontrolleve, konstatohet se vula e përbaruesve gjyqësorë privatë përdoret nga persona të tretë ose nga subjekti tregtar ku përbaruesi ushtron